



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHITËTËRORE

Nr. 5701 Prot.

Tiranë, më 18/3.2020

VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONARIT

Nr. 28 Datë 18/3/2020

PËR

PRISHJEN E SHOQËRISË “ALBKONTROLL” SH.A, DURRËS

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe Statutit të shoqërisë, për shkak të situatës së vështirë ekonomiko-financiare dhe humbjes së objektit kryesor të aktivitetit, me cilësinë e aksionarit mazhoritar të shoqërisë “Albkontroll” sh.a Durrës,

VENDOSA:

1. Prishjen e shoqërisë “Albkontroll” sha Durrës dhe shpalljen e saj në likuidim.
2. Likuidator i shoqërisë emërohet Z. Eraldo Mene, aktualisht Administrator i kësaj shoqërie.
3. Të hartohet bilanci i likuidimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
4. Znj. Margarita Kalemasi, Audituese Ligjor të kryejë certifikimin e Bilancit të likuidimit.
5. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

